


fakto

Keqpërdorimi dhe lënia pas dore e personave të moshuar

Deri në paraqitjen e inicijativës për trajtimin e problemit për keqpërdorimin e fëmijëve në çerekun e fundit të shek. 20-të, keqpërdorimi dhe lënia pas dore e më të vjetërve ngeli punë private, mirë e fshehur nga shikimi i shoqërisë. Sot, edhe më shpesh ajo shihet si problem me rëndësi siç duket se rritet, përshkak se shumë shtete ballafaqohen me popullatw që shumë shpejtë plaket. Parashihet se deri më vitin 2025, popullsia botërore e personave nga 60vj. e sipër do të rritet më tepër se dyherë, prej 542 milion më vitin 1995 përafërsisht në 1,2 miliardë.

Rritja e proektuar e popullsisë botërore prej moshës 60 vj. e sipër, 1995-2025



Ngjajshëm me llojet e tjera të dhunës, maltretimi i më të vjetërve përfshinë keqpërdorim fizik, seksual dhe psikik poashtu edhe lënie pas dore. Por, personat më të moshuar janë të ndijshëm edhe në keqpërdorimin ekonomik, ndaj se të tjerët nw mwnyrw jo adekuate i shfrytëzojnë mjetet e tyre.

SHKALLA E PROBLEMIT

Informacionet për shkallën e keqpërdorimit të personave të moshuar janë të pakta. Studimet e pakta që janë bërë popullatws tregojnë se ndërmyet 4% dhe 6% nga personat e moshuar kanë mbijetuar një lloj forme të keqpërdorimit në shtëpi.

Personat e moshuar janë në rrezik të lënies pas dore poashtu edhe në institucione siç janë spitalet, shtëpi të pleqve dhe organizata tjera për kujdes afatgjate.P.sh., në një analizë të Kombeve të bashkuara, 36% nga personeli nw shtëpitw e pleqëve kanë paraqitur se kanë qenë dëshmitarë të një incidenti të keqpërdorimit fizik ndaj një pacienti më të vjetër në vitin e kaluar, 10% pranuan se vetë ato kanë kryer më së paku një akt të maltretimit fizik, kurse 40% kanë thënë se kanë pasur pacientë me maltretime psigjike.

Këto lloj aktesh në institucionet për persona të moshuar përmbajnë kufizime fizike të pacintëve, i privon nga dinjiteti dhe zgjedhja në punët ditore dhe dhënje kujdes jo të mjaftueshme (p.sh., të lehen që të zhvillohen pasojat e shtypjes).

PASOJAT NGA KEQPËRDORIMI I PERSONAVE TË MOSHUAR

Për personat e moshuar, pasojat nga keqpërdorimi mund të jenë veçanwrishtë serioze, për shkak se eshtrat e tyre janë më të ashpra dhe përmirsimi zgjatë më tepër. Edhe një lëndim relativisht i imët mund të bëj dëm serioz dhr të përhershëm.

KUSH JANË FAKTORËT-RREZIK PËR KEQPËRDORIMIN E PERSONAVE TË MOSHUAR?

Egzistojnë shumë situata kur personat e moshuar i janw tw vënë në rrezik prej dhunës. Në disa raste,mardhëniet familjare mund të keqësohen si rezultat i stresit dhe frustimeve, pasi që personi i moshuar bëhet më mvarun. Tw tjerët, mvarshmëria e dhënësit të kujdesit prej personit të moshuar përshkak të vendnabimit ose përkrahjes financiare mund të jenë burim i konfliktit.

Izolimi social është faktorë rreziku i rëndësishëm për personin e moshuar që të mbijetojë maltretim. Shumë persona të moshuar janë të izoluar përshkak dobësisë fizike ose mentale, ose nëpërmjet humbjes së shokëve antarëve të familjes.



Organizata botërore e shëndetësisë



Ministria e shëndetësis, RM



Enti Republikan për mbrojtje shëndetsore



Fondacioni Instituti i Hapur i Shoqëris Civile në Maqedoni



Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi gjnore në RM



Faktorër kulturor dhe socio-ekonomik të cilët mund të ndikojnë ndaj rrezikut të lënies pas dore janë:

- Pasqyra për njerëzit më të moshuar si të thyeshwem, të lishtë dhe të mvarun,
- Erozim i lidhjeve mes gjeneratave në familje,
- Restrukturimi i rrjetit kryesor për përkrahje të të moshuarve,
- Sistemi i trashigimisw dhe të drejtws mbi pronwn ndikojnë mbi shpërndarjen e fuqisë sw të mirave materiale në familjet,
- Migrimi i çiftit të ri në pjesë tjera, duke i lënë prindërit e moshuar vetëm, në shoqëri ku për të vjetërit tradicionalisht janë kujdesur fëmijët e tyre.

Burat e moshuar janë gati se nw tw njejtin rrezik nga lenia pas dore siç edhe gratë. Por, në kulturat ku gratw kanë statutin social inferior, gratw e moshuara janë në rrezik të veçantë nga lënia dhe hubmjën e të drejtës mbi pasurinë kur mbesin të veja.

Në institucionet, më e besueshme është që të vjenë në keqpërdorim atje ku standardet janë të ulta, personeli është dobët i trajnuar ose ka tepër punë, interakcionet ndërmjet personelit dhe banuesit në institucionet janë të rënduara, ambienti fizik është i pakënaqshëm dhe ku politika është në interes të institucionit, e jo në interes të banorwve të saj.

ÇKA MUND TË BËHET QË TË PARANDALOHET KEQPËRDORIMI I PERSONAVE TË MOSHUAR?

Vendet në botë janë në faza të ndryshme në përgjigjen e tyre nacionale dhe lokale të kujdesit dhe mbrojtjes të personave të moshuar. Dhe pwrderisa disa vende ja bashkangjesin keqpërdorimin e personave të moshuar ligjeve tw tyre dhe kanë plotësishtë të zhvilluar sistemin e paraqitjes dhe trajtimin e rasteve të keqpërdorura, të tjerët kanë përgjegje më të kufizuara.

Shërbime sociale

Në përgjithësi, vendet që ju japin shërbim të të malretuarve, apo personave të lënw pas dore ose të eksploatuar, atë e kanë bërë nëpërmjet rrjetit të përhershëm të shëndetësisë dhe shërbimeve sociale. Shërbimet e tilla zakonisht përmbajnë ndihmë mjeksore, juridike, psikologjike dhe financiare, poashtu edhe ndihmë për banim dhe për pyetje tjera në lidhje me mjedisin.

Intervenime tjera përfshijnë, strehimore për situata urgjente, grupe për përkrahje konkretisht për persona të moshuar të lënë pas dore dhe linje telefonike për ndihmë. Në disa vende të varfura, ishin bwrw proekte lokale që t'i ndihmojnë personave më të moshuar që të planifikojnë programe dhe të zhvillojnë shërbime të veta.

Mbrojtja shëndetësore

Në disa vende, fela mjekësore luajti rolin udhëheqës në nxitjen e publikut në lidhje me keqpërdorimin e personave të moshuar. Përsëri, pak programe intevante për mbrojtjen e personave të moshuar janë të vendosura në spitale, dhe shumë mjek nuk diagnostifikojnë lënien pas dore ose maltretimet, përshkak se edhe ajo nuk është pjesë e trajnimit të tyre.

Disa nga shenjat dhe simptomet të keqpërdorimit janë:

- dallimi kohor në mes lëndimit ose sëmundjes dhe kërkimit tw ndihmës mjeksore,
- shpjegime të pabesueshme dhe të paqarta për lëndimet ose sëmundjen, ose nga ana e pacientit,ose nga ana e atijë që pwrkujdeset,
- vizita të shpeshta në repartin urgjent përshkak të keqësimit të gjendjes kronike përskej kujdesit dhe mjeteve pwr ballafaqimin më këtë në shtëpi,
- pacient më të vjetër funksional të invalidizuar që mbrinë pa kryesorin që përkujdeset për të,
- rezultate laboratorike që nuk përputhen me anamnezën e dhënë.

Fushata edukative për ngritjen e vetëdijes së opinionit

Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së opinionit janë elemente me rëndësi për ndërprerjen e lënies pas dore dhe maltretimit. Qëllimi i tw gjitha këtyre pwrpjekjeve është informimi i mjekëve dhe opinionit të gjërë për llojet e ndryshme të keqpërdorimit, se si të vërtetohen shenjat dhe simptomet e keqpërdorimit dhe ku mund të meret ndihma.

Mediumet mundet, poashtu të jenë mjet i mundshëm për ndrimin e qëndrimeve dhe zvoglimin e stereotipeve për personat e moshuar.

Programet edukative për personat e moshuar thjeshtë janë më të sukseshme në qoftë se informatat për lënien pas dore dhe maltretimet janë të gërshetuara me tema më të gjëra, siç është plakja e sukseshme ose mbrojtja shëndetësore.